



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1154 Prot.

Roskovec, më 27.02 2020

VENDIM

NR 15, DATË 24.02.2020

“PËR MIRATIM DHE TRANSFERIM FONDESH NË BUXHETIN E BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2020”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, neni 24 pika 1 dhe neni 54 pika dh, të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore” neni 20 pika 1 dhe neni 45, të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”i ndryshuar neni 44 pika b, të ligjit nr.22/2018 “Për strehim social” neni 67 pika b, të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.31 datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti I shtetit për programet e strehimit”, të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.116 datë 20.12.2019 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të bashkisë dhe ndërmarrjeve vartëse si dhe niveli maksimal i pagave për vitin 2020” Këshilli i Bashkisë :

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit prej 8,892.64 euro ose **1,382,534 lekë** për projektin “**Rikonstruksionin e rrugës “Liqeni i Kurjanit”**”, investim i cili financohet nga Këshilli i Evropës, në kuadër të projektit i cili zbatohet në Bashkinë Roskovec “Romacted”.
 - a. Shtohet plani i të ardhurave 2020 zëri “Grante nga ndihma ndërkombëtare” me **1,382,534 lekë**.
 - b. Shtohen plani i shpenzimeve nga fondi i financimit nga Këshilli i Evropës, në kuadër të projektit i cili zbatohet në Bashkinë Roskovec “Romacted”, si më poshtë vijon:
Shtohet : Gr.00 Tit.04520 Kap.05 Art.231 **1,382,534 lekë**
2. Miratimin e fondit prej **3,600,000 lekë** financim 20% i Bashkisë Roskovec për projektin “Përmirësimi I kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara”, së bashku me financimin e buxhetit të shtetit (Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për vitin 2020), fond i cili të përballohet : 2,000,000 lekë nga zëri “Karburant vaj dhe graso” I planifikuar për Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirëmbajtjes, ndërsa 1,600,000 lekë nga Fondi Rezervë për vitin 2020 :



Shtohet :

Gr.00 Tit.06190 Kap.05 Art.231 Kodi I institucionit. 2113001 **3,600,000 lekë**

Pakësohet :

Gr.00 Tit.01110 Kap.05 Art.604 Kodi I institucionit. 2113001 **1,600,000 lekë**

Gr.00 Tit.04520 Kap.05 Art.602 Kodi I institucionit. 2113002 **2,000,000 lekë**

3. Miratimin e ndryshimit të përdorimit të fondit për objektin “Rikonstruksion i rrugëve të parcelave me punëtori të bashkisë” prej 10,000,000 lekë si më poshtë vijon :
- a. 5,000,000 lekë për blerjen e një skrepi
 - b. 2,000,000 lekë për blerjen e një mjeti vetëshkarkues
 - c. 3,000,000 lekë për blerje të materiale inerte
4. Miratimin e fondit prej **300,000 lekë** për objektin “Blerja e dy copë WC portative”, fond i cili të përballohet nga zëri “Blerje materjale për rrugë e trotuare dhe sektorin e dekorin gjatë vitit” i planifikuar për Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirëmbajtjes për vitin 2020:

Shtohet :

Gr.00 Tit.01110 Kap.05 Art.231 Kodi I institucionit. 2113001 **300,000 lekë**

Pakësohet :

Gr.00 Tit.04520 Kap.05 Art.602 Kodi I institucionit. 2113002 **300,000 lekë**

5. Miratimin e fondit prej **200,000 lekë** për objektin “Ndërtim i bustit “Adem Vrapi”,fond i cili të përballohet nga zëri “Blerje materjale për dekorin” I planifikuar për Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirëmbajtjes për vitin 2020:

Shtohet :

Gr.00 Tit.08230 Kap.05 Art.602 Kodi I institucionit. 2113001 **200,000 lekë**

Pakësohet :

Gr.00 Tit.06440 Kap.05 Art.602 Kodi I institucionit. 2113002 **200,000 lekë**

6. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Menaxhimit të Projekteve Sociale, Koordinimit me BE dhe Shërbimeve Komunitare për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

Kadri Hyska

